



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 930 Prot.

Tiranë, më 27.06 2019

**VENDIM Nr. 173, datë 25.06.2019**

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, *Neni 48 dhe VKM Nr. 786, datë 26.12.2018 "Për miratimin e zonave arkeologjike "A" dhe "B", të qytetit të Durrësit dhe të Planit për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre"* Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 8, datë 25.06.2019, pasi shqyrtoi kërkesën për miratim të projektit "*Ndërtimi i zyrave të Drejtorisë Rajonale të OSHEE Durrës" rruga "Kristaq Rama dhe "Bulevardi Dyrrah", zonë arkeologjike "B" Durrës*-subjekti Drejtoria Rajonale e OSHEE Durrës, relacioni për pritshmërinë arkeologjike dhe koncepti i realizimit të sondazheve për zonën ku zhvillohet projekti, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k..

**VENDOSI:**

1. Të miratojë relacionin për pritshmërinë arkeologjike dhe konceptin e realizimit të sondazheve për zonën ku zhvillohet projekti, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k.
2. Subjekti Drejtoria Rajonale e OSHEE, Durrës duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të realizojë sondazhet arkeologjike, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt. Raporti i tyre do të paraqitet në KKA e radhës.
3. Investitori Drejtoria Rajonale e OSHEE, Durrës duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Investitori Drejtoria Rajonale e OSHEE, Durrës si dhe subjekti i licencuar në arkeologji, i cili do të kryejë sondazhet arkeologjike, në mbështetje të legjislacionit në fuqi dhe akt-marrëveshjes tre palëshe të sipërcituar, janë të detyruar të marrin të gjitha masat për sigurimin dhe ruajtjen e kantierit, si dhe ruajtjen e strukturave arkeologjike, të cilat mund të zbulohen gjatë kryerjes së sondazheve, deri në vendimmarrjen përfundimtare të KKA, në lidhje me to.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi,

**KRYETAR  
ELVA MARGARITI  
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO**

